



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**Miratuar me Vendimin nr. 218, datë 12.10.2016
Ndryshuar me Vendimin nr. 246, datë 21.12. 2016 të AMA-s**

**RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR RENDITJEN E SHËRBIMEVE
AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE QË MBËSHËTETEN NË RRJETE NUMERIKE**

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i planit të renditjes, kriterëve dhe procedurës së caktimit të numrit identifikues për ofruesit e shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv.

**Neni 2
Baza ligjore**

1. Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012 “Për miratimin e Strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike”.

**Neni 3
Fusha e zbatimit**

1. Kjo rregullore zbatohet për subjektet audio/audiovizivë të pajisur me licencë për ofrimin e shërbimit të programit audio dhe/ose audiovizive në rrjetet numerike tokësore.

**Neni 4
Përkufizime**



Termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. “AMA” është Autoriteti i Mediave Audiovizive.
2. “Ofrues shërbimi mediatic audioviziv (OSHMA)” është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.
3. “Udhëzuesi elektronik i programit” është mënyra elektronike e informimit të publikut lidhur me listën dhe orarin e programeve nga shërbimi i transmetimit, e cila është pjesë përbërëse e sistemit të transmetimit.
4. “Numri Logjik i Programit (NLP)” është numri i përcaktuar nga AMA për identifikimin e një shërbimi programi audio dhe/ose audioviziv.
5. “Plani i renditjes” është lista e përcaktuar nga AMA për renditjen e shërbimeve programore që mbështeten në rrjetet numerike.
6. Allotment” është zona gjeografike që mbulohet me një rrjet televiziv numerik me një frekuencë (SFN-Single Frequency Network).
7. “Segment numërimi” është blloku i numrave i caktuar për radhitjen e shërbimeve të ndryshme programore në planin e renditjes.
8. “Buqetë programore” është tërësia e programeve që transmetohen në një rrjet numerik të vetëm audio/audioviziv.
9. “Shërbim programor i përgjithshëm” është shërbimi programor me përmbajtje të shumëllojshme, i cili mund të jetë kombëtar, rajonal ose lokal.
10. “Shërbim programor tematik” është shërbimi programor që të paktën 70% të kohës së transmetimit ia dedikon përmbajtjeve mbi një tematikë të caktuar: informacion; të mitur; kulturë dhe shkencë; filma; sport; shqip; muzikë, etj.
11. “Shërbim programor për të mitur” është shërbimi programor tematik me përmbajtje që i dedikohen grupmoshave deri në 18 vjeç, me qëllim, informimin, edukimin dhe argëtimin, duke respektuar liritë dhe të drejtat e tyre.
12. “Shërbim programor informativ” është shërbimi programor tematik me përmbajtje dedikuar informacionit, me lajme, rubrika të aktualitetit, kronika, reportazhe, debate dhe lidhje të drejtpërdrejta, biseda apo forume mbi aspekte të ndryshme të zhvillimit social, ekonomik, politik, kulturor etj.
13. “Shërbim programor kulturë dhe shkencë” është shërbimi programor tematik me përmbajtje edukative, historike, artistike, letrare ose shkencore, dokumentarë dhe emisione të aktualitetit shkencor dhe teknologjik, me karakter argëtues, vepra audiovizive europiane, pjesë teatrale, lirike etj.
14. “Shërbim programor film” është shërbimi programor tematik i dedikuar për transmetimin e filmave artistikë, televizivë, seriale, etj.



15. "Shërbim programor muzikë" është shërbimi programor tematik i dedikuar të gjitha rrymave krijuese e interpretuese, me përmbajtje të regjistruara ose live, informacion dhe diskutime mbi ngjarje muzikore nga vendi e bota etj.
16. "Shërbim programor sport" është shërbimi programor tematik i dedikuar sportit, me ngjarje lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të transmetuara direkt ose të regjistruara, lajme dhe emisione diskutimesh nga zhvillime të ndryshme sportive.
17. "Shërbim programor shqip" është shërbimi programor tematik me programe tërësisht në gjuhën shqipe, për nxitjen dhe promovimin e gjuhës e kulturës kombëtare, si filma, dokumentarë, përmbajtje zbavitëse e argëtuese etj.
18. "Shërbim programor teleshitje" është shërbimi programor tematik që përbën një ofertë të drejtpërdrejtë për publikun për shitjen apo sigurimin e mallrave, shërbimeve ose pasurive të tjera të paluajtshme apo pronësisë intelektuale.
19. "Shërbim programor me akses të kushtëzuar" është shërbimi programor që ofrohet për qëllim fitimi mbi bazën e aksesit të kushtëzuar.

Neni 5

Struktura e programeve

1. Duke mos përjashtuar të drejtën e çdo abonenti të riorganizojë programet e ofruara nga OSHMA-të e mbështetura në rrjete numerike, ky nen përcakton planin e renditjes së programeve (hapur dhe/ose me akses të kushtëzuar) në rrjetet numerike, mbështetur në skemën e mëposhtme:

Segmenti I	Programe kombëtare, rajonale, lokale
Segmenti II	Programe kombëtare, rajonale, lokale
Segmenti III	Programe rajonale, lokale
Segmenti IV	Programe kombëtare me akses të kushtëzuar
Segmenti V	Programe kombëtare me akses të kushtëzuar
Segmenti VI	Programe rajonale, lokale me akses të kushtëzuar
Segmenti VII	Programe kombëtare, rajonale, lokale
Segmenti VIII	Programe kombëtare, rajonale, lokale
Segmenti IX	Programe audio e shërbime të tjera
Segmenti X	Programe lokale

2. Programeve të përgjithshme kombëtare publike dhe private u rezervohen numrat nga 1 në 10.
3. Programeve tematike kombëtare publike dhe private u rezervohen numrat nga 11 në 20.



4. Për secilën OSHMA të autorizuar për ofrimin e shërbimeve me akses të kushtëzuar rezervohen 33 NLP të njëpasnjëshme.
5. Shërbimeve të tjera si Udhëzuesit Elektronik të Programit dhe shërbimeve të tjera të veçanta u rezervohen numrat 0, 100, 200, 300, 400, 500, 600, 700, 800 dhe 900.

Neni 6 Struktura e segmenteve

Bazuar në skemën e përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje, dekoderët përfshirë ata të integruar në aparatet marrës televizivë duhet të disponojnë një ndërfaqe grafike që duhet të paraqesë të paktën listën e gjithë programeve kombëtare, rajonale e lokale e numrin përkatës të akorduar secilit program nëpërmjet NLP që lehtëson përdorimin nga abonentët.

1. Në segmentin I, do të përfshihen programet e përgjithshme kombëtare, rajonale, lokale publike dhe private që transmetohen hapur.
2. Në segmentin II, do të përfshihen programet e përgjithshme kombëtare, rajonale, lokale publike dhe private që transmetohen hapur.
3. Në segmentin III, do të përfshihen programet tematike rajonale, lokale publike dhe private që transmetohen hapur.
4. Në segmentet IV dhe V do të përfshihen programet publike dhe private që transmetohen me akses të kushtëzuar. Programet brenda secilës buqetë programore duhet të renditen si më poshtë:
 1. Programe të përgjithshme
 2. Të mitur
 3. Programe Informative
 4. Kulturë dhe Shkencë
 5. Filma
 6. Sport
 7. Shqip
 8. Muzikë
 9. Teleshitje

Shërbimet me akses të kushtëzuar që i drejtohen një publiku të rritur duhet të mos transmetohen pa siguruar mbrojtjen e të miturve nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror.



5. Në segmentin VI, do të përfshihen programet rajonale, lokale publike dhe private që transmetohen me akses të kushtëzuar. Programet brenda secilës buqetë programore duhet të renditen si më poshtë:

1. Programe të përgjithshme
2. Të mitur
3. Programe Informative
4. Kulturë dhe Shkencë
5. Filma
6. Sport
7. Shqip
8. Muzike
9. Teleshitje

Shërbimet me akses të kushtëzuar që i drejtohen një publiku të rritur duhet të mos transmetohen pa siguruar mbrojtjen e të miturve nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror.

6. Në segmentin VII, do të përfshihen programet kombëtare, rajonale dhe lokale, që transmetohen hapur.

7. Në segmentin VIII, do të përfshihen programet që dublojnë në formatin HD, programet e transmetuara në SD dhe anasjelltas. OSHMA që transmetojnë programe në formatin SD në segmentet I, II dhe VII kur është e mundur ruajnë të njëjtin numër në segmentin VIII dhe OSHMA që transmetojnë programe në formatin HD në segmentet I, II dhe VII kur është e mundur ruajnë të njëjtin numër në segmentin VIII.

8. Në segmentin IX, do të përfshihen programet Audio e shërbime të tjera.

9. Në segmentin X, do të përfshihen programet lokale.

Neni 7

Klasifikimi i OSHMA-ve

1. OSHMA-të ekzistuese sipas formës së pronësisë mbi kapitalin dhe qëllimit të veprimtarisë klasifikohen në publik dhe private.
2. OSHMA-të private ekzistues, për nevoja të caktimit të NLP-së, në varësi të mbulimit të territorit sipas licencës të lëshuar nga AMA klasifikohen në kombëtarë, rajonalë dhe lokalë.



Neni 8

Kritere të përgjithshme për përcaktimin e NLP-së

1. AMA në përcaktimin e NLP mban në konsideratë kriteret e përgjithshme si më poshtë vijon:
 - a. Shërbimi programor i licencuar nga AMA ka përparësi ndaj shërbimit programor të licencuar jashtë Republikës së Shqipërisë.
 - b. Shërbimi programor kombëtar i përgjithshëm ka përparësi ndaj shërbimit programor kombëtar tematik.
 - c. Shërbimi programor kombëtar i transmetuesit publik ka përparësi ndaj shërbimit programor kombëtar të përgjithshëm të transmetuesve privatë kombëtarë.
 - d. Shërbimi programor kombëtar tematik i transmetuesit publik ka përparësi ndaj shërbimit programor kombëtar tematik të transmetuesve private kombëtarë.
 - e. Shërbimet programore kombëtare tematike të transmetuesit publik dhe të operatorëve privatë kombëtarë kanë përparësi ndaj shërbimeve programore rajonale dhe lokale private. Ky parim nuk zbatohet për shërbimet programore të operatorëve rajonalë të licencuara me afat deri në mbylljen e transmetimeve analoge.

Neni 8/1

1. Caktimi i NLP-së së shërbimeve programore kombëtare të përgjithshme bëhet në përputhje me renditjen e rezultuar nga matja e audiencës audiovizive.
2. Shërbimet programore kombëtare të përgjithshme të operatorëve analogë privatë kombëtarë të licencuar nëpërmjet procedurës *“beauty contest”* kanë përparësi ndaj programeve të operatorëve kombëtarë private të licencuar sipas procedurës së licencimit të rrjeteve numerike. Ndërmjet operatorëve privatë kombëtare të licencuar sipas procedurës *“beauty contest”* kanë përparësi shërbimet programore kombëtare të licencuar sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 *“Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”*. Shërbimet programore kombëtare të përgjithshme, deri në përfundim të matjes së audiencës audiovizive, do të pajisen me NLP të përkohshme, të vlefshme deri në datën 31 dhjetor 2017.
3. Caktimi i NLP-së së shërbimeve programore kombëtare të përgjithshme do të bëhet me short, sipas procedurës së parashikuar në këtë rregullore.



Neni 9

Caktimi i NLP-së për shërbimet programore tematike private kombëtare

1. Renditja e shërbimeve programore tematike private kombëtare do të kryhet sipas tematikave, si vijon:
 - a. Të mitur
 - b. Program Informativ
 - c. Kulturë dhe Shkencë
 - d. Film
 - e. Sport
 - f. Shqip
 - g. Muzikë
 - h. Teleshitje
2. Caktimi i NLP-së për shërbime programore tematike private kombëtare të së njëjtës tematikë do të bëhet me short sipas procedurës së parashikuar në këtë rregullore.

Neni 10

Kritere të veçanta të vlerësimit për dhënien e NLP, OSHMA private rajonalë/lokalë

1. Caktimi i NLP-së për programet e OSHMA-ve private rajonale/lokale do të bëhet në përputhje me numrin e popullsisë që mbulohet me shërbimin audioviziv të OSHMA – së licencuar, të kategorizuar si më poshtë vijon:
 - a. Zonë licencimi me popullsi më shumë se 2,000,000 banorë;
 - b. Zonë licencimi me popullsi nga 1,000,000 deri në 2,000,000 banorë;
 - c. Zonë licencimi me popullsi me pak se 1,000,000 banorë.

Pas caktimit të NLP-së së shërbimeve programore ekzistuese, për secilën nga kategoritë e mësipërme do të rezervohen 5 (pesë) vende NLP-je bosh për OSHMA-të që do të licencohen në vijim.

2. Kriteret e veçanta të vlerësimit për caktimin e NLP-së për programet e OSHMA-ve ekzistues brenda çdo zone licencimi të cituar në pikën 1 të këtij neni janë:
 - a. Data e dhënies së licencës për transmetime analoge;
 - b. Numri i të punësuarve të deklaruar, të vërtetuar nga organet kompetente shtetërore;
 - c. Xhiroja vjetore e deklaruar pranë organeve tatimore;
3. Caktimi i NLP-së për programet e OSHMA-ve private rajonalë/lokalë do të bëhet në përputhje me shumën e pikëve të fituara nga vlerësimi i kritereve të përcaktuara në



- pikën 2 të këtij neni. OSHMA që do të grumbullojë numrin më të madh të pikëve do të përfitojë numrin më të ulët të NLP.
4. Vlerësimi për kriteret e përcaktuara në pikën 2, gërmat “b” dhe “c”, të këtij neni do të bëhet për periudhën nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 97/2013, deri në datën e depozitimit të dokumentacionit përkatës në AMA.
 5. Kriteret e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni do të vlerësohen me formulën si më poshtë vijon:
 - 5.1. Totali i numrit të punonjësve do të llogaritet mbi mesataren e numrit të punonjësve të deklaruar në bazë mujore.

OSHMA që rezulton me numrin më lartë të punonjësve të siguruar sipas gërmës “b” të këtij neni vlerësohet me 100 pikë. Vlerësimi i subjekteve të tjerë do të llogaritet me përqindjen që numri i punonjësve të tyre zë në raport me numrin e punonjësve të OSHMA-së të vlerësuar me 100 pikë.
 - 5.2. OSHMA që rezulton me xhiron vjetore mesatare më të lartë, sipas gërmës “c” të këtij neni vlerësohet me 100 pikë. Vlerësimi i subjekteve të tjerë do të llogaritet me përqindjen që vlera e xhiros vjetore mesatare të tyre zë në raport me vlerën e xhiros vjetore mesatare të OSHMA-së të vlerësuar me 100 pikë.
 - 5.3. Njësia matëse për kriterin e datës së licencimit do të jetë e shprehur në ditë, e llogaritur nga data e licencimit deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore. OSHMA që rezulton me datën më të hershme të licencimit do të vlerësohet me 100 pikë. Vlerësimi i subjekteve të tjerë do të llogaritet me përqindjen që ditët e licencimit të tyre zënë në raport me datën e licencimit të OSHMA-së të vlerësuar me 100 pikë.
 6. Në rast se në përfundim të procesit të vlerësimit të kriterëve OSHMA do të rezultojnë me pikë të njëjta, caktimi i NLP-së do të bëhet me short, sipas procedurës së përcaktuar në këtë rregullore.
 7. AMA kërkon nga OSHMA-të depozitimin e dokumentacionit të kërkuar në pikën 2 gërmat b, dhe c, duke caktuar edhe afatin përfundimtar të dorëzimit të tyre.
 8. OSHMA që nuk depoziton dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të caktuar nuk do të marrë pikë në procesin e vlerësimit lidhur me dokumentacionin që mungon.

Neni 10/1

1. Caktimi i NLP-së së shërbimeve programore private rajonale dhe lokale bëhet në përputhje me renditjen e rezultuar nga matja e audiencës audiovizive.
2. Shërbimet programore private rajonale dhe lokale, deri në përfundim të matjes së audiencës audiovizive, do të pajisen me NLP të përkohshme, të vlefshme deri në datën 31 dhjetor 2018, sipas procedurës së parashikuar në këtë rregullore.”



Neni 11

Kriteret e vlerësimit për shërbimin programor kombëtar me akses të kushtëzuar

1. Programet kombëtare me akses të kushtëzuar do të renditen në grup në bazë OSHMA-je.
2. Programet brenda secilës buqetë programore të OSHMA-së që ofron programe me akses të kushtëzuar duhet të renditen sipas përcaktimit në pikën 4 të nenit 6.
3. Caktimi i NLP-së për programet e OSHMA-ve me akses të kushtëzuar do të bëhet si më poshtë vijon:
 - a. Programet me akses të kushtëzuar të operatorit publik kanë përparësi ndaj programeve me akses të kushtëzuar të operatorëve privatë.
 - b. Programet me akses të kushtëzuar të OSHMA private kombëtare kanë përparësi ndaj programeve me akses të kushtëzuar të OSHMA privatë rajonale dhe lokale.
 - c. Programet me akses të kushtëzuar të operatorëve kombëtarë privatë të licencuar nëpërmjet procedurës “*beauty contest*” kanë përparësi ndaj programeve të operatorëve kombëtarë private të licencuar sipas procedurës së licencimit të rrjeteve numerike.
 - d. Ndërmjet operatorëve privatë kombëtarë të licencuar sipas procedurës “*beauty contest*” kriteret për caktimin e NLP-së janë si më poshtë vijon:
 - OSHMA-të me eksperiencë në transmetimet numerike kanë përparësi ndaj operatorëve privatë historikë kombëtarë;
 - midis OSHMA-ve privatë historikë kombëtarë ka përparësi OSHMA që ka grumbulluar numrin më të madh të pikëve në procesin e vlerësimit në caktimin e NLP-së për programin e përgjithshëm.
 - e. Ndërmjet operatorëve kombëtarë private të licencuar sipas procedurës së licencimit të rrjeteve numerike kombëtare do të kenë përparësi operatorët e vlerësuar me numrin më të madh të pikëve gjatë procedurës së licencimit.

Neni 12

Kriteret e vlerësimit për shërbimin programor rajonal ose lokal me akses të kushtëzuar

1. Programet rajonale dhe lokale me akses të kushtëzuar do të renditen në grup në bazë OSHMA-je.



2. Programet brenda secilës buqetë programore të OSHMA-së që ofron programe me akses të kushtëzuar duhet të renditen sipas përcaktimit në pikën 5 të nenit 6.
3. Caktimi i NLP-së për programet e OSHMA-ve me akses të kushtëzuar do të bëhet si më poshtë vijon:
 - a. Programet rajonale ose lokale me akses të kushtëzuar të operatorit publik kanë përparësi ndaj programeve rajonale ose lokale me akses të kushtëzuar të operatorëve private;
 - b. Programet me akses të kushtëzuar të operatorëve rajonale ose lokale private të licencuar sipas procedurës së parashikuar në dispozitat tranzitore të ligjit nr. 97/2013 për aplikim të përbashkët për marrjen e një licence rrjeti numerik kanë përparësi ndaj programeve të operatorëve rajonale ose lokale private të licencuar sipas procedurës së licencimit të rrjeteve numerike;
 - c. Ndërmjet operatorëve rajonale ose lokale private të licencuar sipas procedurës së parashikuar në dispozitat tranzitore të ligjit nr. 97/2013 për aplikim të përbashkët për marrjen e një licence rrjeti renditja do të kryhet sipas rendit të allotmenteve të përcaktuar në nenin 13 pika 2;
 - d. Ndërmjet operatorëve rajonale ose lokale private të licencuar sipas procedurës së licencimit të rrjeteve numerike renditja do të kryhet sipas rendit të allotmenteve në nenin 13, pika 2. Renditja e operatorëve brenda çdo allotmenti do të kryhet në varësi të pikëve të marra në procedurën e licencimit të rrjeteve numerike.

Neni 13

Procedura e dhënies së NLP programeve ekzistuese

1. Plani i renditjes së shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive publikohet në faqen zyrtare të AMA-s.
2. Rendi i allotmenteve në numërimin e programeve do të jetë sipas numrit të popullsisë së çdo allotmenti.
3. Për çdo allotment do të rezervohet 30% deri në 50% e numrit të operatorëve ekzistues për operatorët e rinj.
4. Procedura e dhënies së NLP-së do të kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për dhënien e NLP-së, i emëruar nga Kryetari i AMA-s.
5. Mbledhjet e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit drejtohen nga Zv/Kryetari në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, pa të drejtë vote, me pjesëmarrjen e të paktën një prej anëtarëve të AMA-s.
6. Komisioni i Vlerësimit për dhënien e NLP-së do të kryejë vlerësimin e subjekteve ekzistues sipas kriterëve të përcaktuara në nenet 10-12. Subjektet që vlerësohen me numrin më të lartë të pikëve përfitojnë numrin më të ulët në segmentin përkatës.



7. Rezultatet e vlerësimit me pikë dhe propozimi për NLP-në e secilit shërbim programor i paraqiten AMA-s në një raport të shoqëruar nga një tabelë përmbledhëse ku shërbimet programore renditen sipas numrit maksimal të pikëve të grumbulluara.
8. Në rast të rezultatit me pikë të njëjta Komisioni i Vlerësimit për dhënien e NLP-së, i propozon AMA organizimin e shortit në përputhje me këtë rregullore.
9. AMA miraton NLP për shërbimet programore ekzistuese. NLP-ja është pjesë përbërëse e tekstit të licencës së OSHMA-së.

Neni 14

Procedura e dhënies së Numrit Logjik të Programit, OSHMA-ve të reja

1. Aplikimi për licencë shërbimi programi audio dhe/ose audiovizive konsiderohet edhe kërkesë për marrjen e NLP-së. NLP-ja jepet nga AMA, bazuar në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit të aplikimit për licencë transmetimi ose licencë shërbimi programi audio dhe/ose audioviziv.
2. NLP-ja/të e OSHMA-së, do të jetë vendi i parë i lirë në segmentin e caktuar për kategorinë përkatëse të programit.

Neni 15

Procedura e Shortit

1. Në rast se në përfundim të procedurës së vlerësimit të kriterëve për dhënien e NLP-së do të rezultojnë OSHMA me pikë të njëjta, përcaktimi i NLP-së do të bëhet me short.
2. Komisioni i Vlerësimit do t'i propozojë AMA organizimin e procesit të shortit me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të OSHMA që do të jenë subjekt i shortit.
3. Përfaqësuesit e OSHMA do të ftohen të marrin pjesë në datën, kohën dhe vendin e përcaktuar nga AMA nëpërmjet shërbimit postar rekomande. Mungesa e përfaqësuesve të OSHMA nuk do të pengojë vazhdimin e procedurës së shortit.
4. Shorti do të realizohet nëpërmjet tërheqjes së emrave të shënuar për çdo OSHMA.
5. Procedura e shortit pasqyrohet në procesverbalin e shortit të mbajtur nga AMA.

Neni 16

Miratimi i ndryshimeve

1. NLP-ja e miratuar për një OSHMA është e vlefshme deri në përfundim të afatit të vlefshmërisë së licencës së OSHMA-së.



2. Në rast se një OSHMA e licencuar ndryshon thelbësisht parametrat e kritereve vlerësuese mbi të cilat është përcaktuar NLP përkatëse, mund të paraqesë pranë AMA-s kërkesë për konfirmimin e NLP-së ekzistuese apo miratimin e një NLP-je të re në përputhje me ndryshimet përkatëse.

Neni 17

Kushtet e përdorimit të planit të renditjes

1. OSHMA-të janë përgjegjës për përdorimin e drejtë të NLP-së së miratuar në përputhje me këtë rregullore.
2. OSHMA-të duhet të garantojnë përputhshmërinë e shërbimeve të ofruara duke respektuar kërkesat ligjore dhe dispozitat e kësaj rregulloreje.
3. OSHMA-të e licencuar për rrjet numerik, përfshirë operatorin publik, i komunikojnë subjekteve të mbështetur në infrastrukturën e tyre transmetuese NLP-në e miratuar. Në kontratën që lidhet mes dy palëve duhet të përcaktohet edhe ndërprerja e menjëhershme e përdorimit të NLP në rastin e pezullimit/heqjes së licencës nga AMA.
4. OSHMA kombëtare kanë të drejtë të këmbëjnë NLP me OSHMA të të njëjtit lloj, me përjashtim të NLP-ve të operatorit publik. Këto ndryshime duhen miratuar paraprakisht nga AMA.
5. OSHMA rajonale ose lokale kanë të drejtë të këmbëjnë NLP-në me OSHMA të të njëjtit lloj me përjashtim të NLP-ve të operatorit publik. Këto ndryshime duhen miratuar paraprakisht nga AMA.
6. Pavarësisht përcaktimeve të kësaj rregulloreje, çdo përdorues ka të drejtë të riorganizojë renditjen e programeve në marrësin e tij televiziv.

Neni 18

Sanksionet

1. AMA, në rast konstatimi të përdorimit nga një OSHMA të një NLP-je të ndryshme nga NLP-ja e miratuar kërkon nga OSHMA-ja që brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit të përdorë NLP-në e miratuar nga AMA.
2. Në rast se OSHMA nuk respekton detyrimin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, AMA vendos pezullimin e licencës dhe të së drejtës së përdorimit të NLP-së, për një periudhë deri në 1 vit dhe ka të drejtë të përshkallëzojë sanksionet deri në heqjen e licencës.



3. Në rastin e shkeljes së kërkesave të ligjit dhe kësaj rregulloreje nga një ose më shumë shërbime programore të një OSHMA-je të licencuar për transmetime numerike, AMA ka të drejtë të ndëshkojë OSHMA e licencuar, vetëm për shërbimin programor që shkel kërkesat ligjore deri në heqjen e NLP-së së këtij shërbimi programor.

Neni 19

Rishikimi i planit të renditjes

AMA rishikon planin e renditjes për renditjen e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive që mbështeten në rrjete numerike jo më pak se një herë në dy vjet, në bazë të zhvillimit të tregut dhe teknologjisë në sektorin e mediave audio dhe audiovizive.

Neni 20

Hyrja në fuqi dhe publikimi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë me miratimin nga AMA në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 97/2013.
2. Kjo rregullore publikohet në faqen e internetit të AMA-s.